

Lajmrimi i ngjarjes nga personat e prekur nga pandemia/endemia

↓
Ekipi Kryqit të kuq, dhe ekipet logjistike (shpërndarje të ndihmave)

Siç poshihet nga skema, rolin kryesor në këtë ngjarje e ka Shtabi/Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim, **IKSH**P (Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës), Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në bashkëpunim me Drejtorin për Shërbime Publike dhe Emergjencë, ndërsa rolin **Operativ kryesor** e ka

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe ekipet mjekësore emergjente, **Qendrën për vaksinonim, Qendrat Operative të Shtabeve Lokale, Ekipet logjistike, kryqi i kuq etj.** Gjatë Pandemisë e cila ishte me përmasa të mëdha, angazhimin kryesor në organizimin dhe menaxhimin e virusit COVID-19, e kishte IKSH, Qendrat Spitalore në kuadër të QKUK-s-së, se bashku me komunat dhe DSHMS-ja, me strukturat e saj.

Ndërsa tek rastet e Epidemive, sëmundjeve infektive lokale me gripeve sezonale, rolin kryesor e ka **DSHMS-ja, me Qendrën e Mjekësisë Familjare, QKM-të dhe AMF-të**

Masat parandaluese në rastet e pandemisë janë:

1. Fushata e informimit rreth simptomave të virusit dhe mënyrat e mbrojtjes;
2. Qëndrimi në shtëpi në rast të simptomave;
3. Vaksinimi;
4. Kufizimet e tubimeve publike, (mbajtja e distancës, vendosja e maskave, larja e duarve etj.);
5. Rritja e kapaciteteve spitalore të QKMF-ve, QKM-ve, AMF-ve, si në aspektin teknik ashtu edhe në atë profesional;
6. Testimet për diagnostikim të virusit.

Masat parandaluese nga epidemitë janë veprime dhe strategji që ndërmerren për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive në komunën e Gllogocit, të cilat janë:

1. Masa hixheno-sanitare;
2. Izolimi dhe karantinimi i rasteve të gripit sezonal;
3. Vaksinim kundër gripit sezonal;
4. Kontrolli i burimeve të infeksionit (kontrolli i insekteve që transmetojnë sëmundje: si mushkonjat për Malarinë, viruseve të ndryshëm etj.);
5. Sigurimi i ujit të pastër,
6. Përgatitja dhe reagimi i institucioneve (sigurimi i furnizimeve mjekësore, ilaçe, pajisje të tjera mjekësore).

PËRFUNDIM

Plani i Reagimit Emergjent Komunal përfaqëson një instrument thelbësor për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së qytetarëve në rast të emergjencave natyrore apo të shkaktuara nga njeriu. Ky plan është hartuar duke u bazuar në vlerësimin e rreziqeve të mundshme në territorin e komunës, kapacitetet ekzistuese të reagimit, si dhe mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstitutional.

Zbatimi i suksesshëm i këtij plani kërkon angazhimin aktiv të të gjitha strukturave komunale, shërbimeve emergjente, institucioneve publike dhe komunitetit.

Trajnimi i vazhdueshëm, komunikimi efektiv dhe koordinimi ndërmjet akterëve janë elemente kyqe për të siguruar një përgjigje efikase dhe të shpejtë ndaj çdo situatë.

Përmes këtij plani, Komuna e demonstroi përkushtimin për të mbrojtur jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve, duke vendosur parimet e parandalimit, përgatitjes, reagimit dhe rimëkëmbjes në qendër të veprimeve të saj.

Ky dokument do të jetë objekt i rishikimeve periodike në përputhje me zhvillimet ligjore, ndryshimet në strukturën e rreziqeve dhe përmirësimet në kapacitetet operationale të Komunës.